



100 Vjet Pavarësi

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

NR. 7 DATË 01.06.2012

P Ë R

MIRATIMIN E STUDIMIT URBANISTIK PJESOR, PËR ZONË HOTELERI DHE REZIDENCA, ME SIP. 6HA, NË PARCELËN 9A PJESË E STUDIMIT URBANISTIK PËR ZONËN TURISTIKE TE GJIRIT TË LALËZIT, ME INVESTITOR SHOQËRINE LURA SHPK, KOMUNA ISHËM, QARKU DURRËS

Në mbështetje të nenit 8, nenit 89 pika 4 të Ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit Nr.87 datë 07.02.2012 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", Vendimit nr 88, "Për një ndryshim në Vendimin nr.502, datë 13.7.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit" dhe Vendimit Nr.345, datë 09.05.2012 të Këshillit të Ministrave "Për një shtesë në vendimin Nr.502, datë 13.07.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit", Këshilli Kombëtar i Territorit

V E N D O S I :

1. Të miratohet "Studimi urbanistik pjesor, për zonë hoteleri dhe rezidenca, me sip. 6ha, në parcelën 9A, pjesë e studimit urbanistik për zonën turistike të Gjirit të Lalëzit, me investitor shoqërinë "Lura" sh.p.k., komuna Ishëm, qarku Durrës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet komuna Ishëm.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

SALI BERISHA

ZEVENDES KRYETAR I KKT-së



SOKOL OLLDASHI

MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

SEKRETARE E KKT-së

KREUZA LEKA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

